

SI MUND TË JEM I SIGURT PËR PARAISËN?



COLIN S. SMITH



Si Mund Të Jem i Sigurt Për Parajsën

Nga Colin S. Smith ©Open the Bible, 2019. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përveç rasteve kur tregohet ndryshe, të gjitha citimet në shqip nga Shkrimi i Shenjtë janë marrë nga version i Biblës “Së bashku” me leje nga Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë si zotëruese e të drejtave të autorit për këtë përkthim. ©2020.

Asnjë pjesë e kësaj publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë apo mënyrë pa lejen paraprake nga Hape Biblën.

Dizajni dhe përpunimi grafik nga High Note Design.

SI MUND TË JEM I SIGURT PËR PARAJSËN?

Si mund të jem i sigurt për parajsën? Vështirë se mund të imagjinohet një pyetje më e rëndësishme se kjo. Është një çështje që prek çdo person në botë. Pavarësisht sa të ndryshëm jemi, të gjithë kemi një gjë të përbashkët—herët a vonë, do të vdesim. Vdekja mund të të vijë këtë javë, këtë muaj, këtë vit, ose mund të jetë ende larg, por një gjë është e sigurt... një ditë ajo do të vijë. Një ditë do të zgjohesh, dhe, pa e ditur, mund të jetë dita jote e fundit këtu mbi tokë. Çfarë do të ndodhë me ty atëherë?

Historia e vjedhësit në kryq na tregon se si mund të jemi të sigurt për parajsën. Kjo histori gjendet te Luka 23:

Ata sollën edhe dy keqbërës të tjerë për t'i kryqëzuar bashkë me Jezuin. Kur arritën te vendi që quhej: «Kafka», kryqëzuan aty Jezuin dhe të dy keqbërësit, njërin në të djathtë e tjetrin në të majtë të tij.

Luka 23:32-33

Më pas, njëri nga keqbërësit i tha Jezuit: «Jezu, kujtohu për mua kur të shkosh në mbretërinë tënde». Jezui iu përgjigj: «Me të vërtetë po të them, sot ti do të jesh me mua në parajsë». (Luka 23:42-43).

Është e natyrshme të mendojmë se njerëzit hyjnë në parajsë duke jetuar një jetë të mirë, por vjedhësi nuk kishte jetuar kështu. Ai ishte kriminel. Në ungjillin e Markut ai përshkruhet si "kushar" dhe krimet e kryera ishin aq të rënda sa që e kishin dënuar me vdekje.

Pavarësisht rrethanave që kishin çuar në dënimin e tij, ishte e qartë se nuk kishte jetuar një jetë të mirë. Vjedhësi e dinte këtë. Ai nuk e kundërshtoi drejtësinë e dënimit të tij, madje tha: "Ne jemi dënuar me të drejtë, se po marrim ndëshkimin e merituar për ato që kemi bërë". (Luka 23:41).

Ky ishte një njeri që nuk kishte jetuar një jetë të mirë dhe tani kohës së tij i kishte ardhur fundi! Ai nuk kishte mundësi të niste një faqe të re në jetën e vet. Me duart e këmbët e gozhduara në kryq, ai nuk mund të bënte asnjë vepër të mirë. E megjithatë, Jezui i tha: "Sot do të jesh me mua në parajsë!".

Kjo është marramendëse e bie ndesh me mënyrën e zakonshme të të menduarit që thotë: "Për t'ia mbërritur parajsës varet sesi e jetoj jetën. Për të hyrë më duhet të jetoj një jetë mjaftueshmërisht të mirë për të kënaqur Perëndinë". Ishte e qartë se vjedhësi as këtë nuk e kishte bërë. Atëherë, si hyri në parajsë ai? Kjo është pyetja.

Lajmi i mirë është se nëse ky keqbërës hyri në parajsë, edhe ti hyn. Historia e tij na tregon se si. Ajo përmbledhet me tre fjalë: kthehu, lyp, beso.

1. KTHEHU

Vjedhësi qëndroi në kryq për të paktën gjashtë orë. Gjatë asaj kohe ndodhi një ndryshim i jashtëzakonshëm në qëndrimin e tij ndaj Jezuit.

Mateu na tregon se u kryqëzuan dy kriminelë — një në secilën anë të Jezuit. "Edhe kusarët [në shumës] që ishin kryqëzuar me të, e përqeshnin në të njëjtën mënyrë". (Mateu 27:44).

Pra, ishin dy kriminelë. Në fillim e shanin të dy Jezuin, por pastaj, ndërsa njëri vazhdoi ta shante, diçka ndryshoi me tjetrin. Këtë ndryshim Bibla e quan pendesë.

Pendesë do të thotë të kthehesh prej vetes tënde me aq sa di, prej mëkatit tënd me aq sa di; te Perëndia me aq sa di (1).

FILLON TË DRUASH PERËNDINË

Vjedhësit, që në fillim e kishte fyer e tallur Jezuin, ia pushtoi shpirtin një qetësi e thellë teksa mendonte për çfarë e priste. Pse po luftoj kundër Perëndisë? Çfarë kuptimi ka kjo, kur shumë shpejt do të qëndroj para Tij e do të jap llogari për jetën time?

Duke iu drejtuar keqbërësit tjetër, i cili vazhdonte ta fyente Jezuin, ai tha: "A nuk e druan Perëndinë, ti që po vuan të njëjtin dënim si ai?". (Luka 23:40).

Vjedhësi i kishte disa njohuri për Perëndinë, por nuk i kishte vënë rëndësi Perëndisë në jetën e tij. Po t'i kishte, nuk do të ishte bërë kriminel. Përkundrazi, i kishte lënë pas dore kërkesat e Perëndisë për jetën e tij dhe kishte ndjekur rrugën e vet. Dhe sa më shumë largohej nga Perëndia, aq më pak e brente ndërgjegja.

Por tani, aty në prag të përjetësisë e pushtoi frika se do të qëndronte para Perëndisë. Droja nga Perëndia është fillimi i kthimit tek Ai dhe të çon në njohjen e Jezu Krishtit si mbretin tënd.

NJEH KRISHTIN SI MBRET

Duke iu drejtuar Jezuit, vjedhësi tha: "Kujtohu për mua kur të shkosh në mbretërinë tënde". (Luka 23:42).

Vjedhësi e kuptoi se Jezui është mbret. Nëse është mbret dhe po shkon drejt vdekjes, ndoshta kur të mbërrijë në anën tjetër, Ai mund të bëjë diçka për të më ndihmuar.

Atij që e njeh si mbret, Jezui i thotë: "Ti do të jesh me mua në parajsë". (Luka 23:43).

Si mund të jemi të sigurt për parajsën? Kthehu! Druaje Perëndinë e nënshtroju Jezu Krishtit si mbretit tënd.

2. Lyp

Vjedhësi lyp: "Jezu, kujtohu për mua kur të shkosh në mbretërinë tënde". (Luka 23:42).

Kjo ishte një kërkesë e guximshme. Para pak çastesh, kishte qenë në një mendje me vjedhësin tjetër, duke derdhur mallkime drejt Jezuit. Nëse Jezui do t'ia mbante mend këtë kur të shkonte në mbretërinë e Tij, atëherë vjedhësi do të ishte i mbaruar. Prandaj, vjedhësi lyp.

LYPA DO TË THOTË QË NUK PRETENDON SE JE I DREJTË

Ai nuk tha: "E di që kam bërë disa gabime, por askush nuk është i përsosur, dhe unë kam bërë shumë gjëra të mira në jetën time". Përkundrazi, ai pranoi: "Ne po marrim ndëshkimin e merituar për ato që kemi bërë". (Luka 23:41).

Ai iu drejtua Krishtit me ndershmëri e përlësi. Pranoi se ishte mëkatar. Ai kishte mëkatuar kundër Perëndisë dhe kundër njerëzve të tjerë. Edhe ne jemi si ai. Kemi dështuar të bëjmë atë që Perëndia na ka thirrur të bëjmë dhe kemi bërë atë që Ai na ka thënë të mos bëjmë. Jemi mëkatarë para Perëndisë së plotfuqishëm.

Dhe pikërisht për këtë arsye shkoi në kryq Jezui, duke u bërë sakrifica dhe zëvendësuesi për mëkatarët. "Zoti ngarkoi mbi të paudhësinë e ne të gjithëve". (Isaia 53:6). Në vdekjen e Tij, Jezui i mbajti mëkatet mbi veten e Tij, që ti të mos i mbash mbi tënden.

LYPË NUK DO TË THOTË PËRPJEKJE PËR UJDI

Nuk na pëlqen të lypim. Ne preferojmë të bëjmë ujdi. Na pëlqen të fitojmë me çka ofrojmë në këmbim: "Unë bëj këtë për ty. Tani, ti bëj këtë për mua".

Por vjedhësi në kryq nuk kishte asgjë për t'i ofruar Jezuit. Ishte duarbosh. Ai mund të bënte vetëm një gjë: të kthehej kah Jezui e të lypte. Dhe pikërisht këtë bëri.

Kjo është e rëndësishme, sepse kur bëhet fjalë për Perëndinë instinkti ynë i parë është të mendojmë në terma ujdje. Nëse lutem... Nëse shkoj në kishë... Nëse bëj bamirësi... Nëse jetoj një jetë të mirë... atëherë Perëndia do të më marrë në parajsë.

Por, ja ç'ndodh nëse i afroresh Perëndisë në këtë mënyrë: së pari e kalon jetën duke menduar se Perëndia të ka borxh, së dyti e var të ardhmen tënde në një ujdje që nuk ekziston, sepse Perëndia nuk bën ujdje.

Të lypësh do të thotë të vish te Jezui duarbosh, duke ditur se nuk ke asgjë për t'i ofruar. E vetmja gjë që mund të bësh është të lypësh. Dhe, duke lypur, e vendos veten tërësisht në mëshirën e Tij dhe shikon drejt Tij për hir.

Ajo që bëri vjedhësi ishte jashtëzakonisht e thjeshtë: filloi të druante Perëndinë. Pranoi gjendjen e tij mëkatore. I kërkoi Jezuit ta shpëtonte, duke besuar në Të si mbretin e tij dhe duke e lënë gjithçka tjetër në duart e Tij.

3. BESO

Imagjino se ke një problem serioz me zemrën dhe të duhet një operacion. Shkon te kirurgu dhe ai të thotë: "Së pari, do të të vë në gjumë, pastaj do të marr një bisturi dhe do të të hap kraharonin".

Më pas ai të shpjegon në detaje gjithë procedurën dhe në fund të dorëzon disa dokumente: "Ja letrat për t'i nënshkruar. Sapo të japësh autorizimin, do të planifikojmë operacionin".

Të sëmurët i nënshkruajnë këto dokumente, sepse e dinë se kirurgu mund të bëjë diçka për ta që ata vetë nuk mund ta bëjnë. Dhe nëse nuk e bëjnë këtë operacion, ata nuk kanë asnjë shpresë tjetër. Prandaj, ia besojnë veten plotësisht duarve të kirurgut dhe thonë: "Pranoj. Të besoj".

Në të njëjtën mënyrë e besoi vjedhësi veten në duart e Jezuit. Çdo personi që beson, Jezui i thotë: "Ti do të jesh me mua në parajsë." Ky është premtimi i Shpëtimtarit për këdo që e vendos besimin e tij te Jezui.

Nëse kthehesh kah Jezui dhe i kërkon të të shpëtojë, ku bazohesh? Te fjala e Tij bazohesh. Te premtimi i Tij. Jezui thotë: "Atë që vjen tek Unë, nuk do ta hedh kurrë jashtë". (Gjoni 6:37). Prandaj, shko tek Ai, lyp prej Tij dhe zëri besë fjalës së Tij!

TË BESOSH PAVARËSISHT ERRËSIRËS

Menjëherë pasi vjedhësi i besoi Jezuit, ndodhi diçka e frikshme: "Errësira mbuloi gjithë tokën..." (Luka 23:44). Kjo errësirë pllakosi në mes të ditës dhe zgjati për tre orë.

Mundohu të vësh veten në vendin e vjedhësit. Sapo i ke besuar jetën Jezuit dhe ke shpresuar për parajsën. Papritur, zhytsh në errësirë, dhe dëgjon Jezuin duke klithur: "Perëndia im, Perëndia im, përse më braktise?". (Mateu 27:46).

Vjedhësi duhet të jetë tronditur: *Çfarë po ndodh kështu?*

Nëse e vendos besimin në Jezu Krishtin, do të ketë momente kur do të përjetosh errësirë të madhe. Mos u habit kur të ndodhë kjo! Ti mund të mbështetesh në premtimin e Jezuit si në errësirë, edhe në dritë.

TË BESOSH PAVARËSISHT DHIMBJES

Kushdo që të thotë se të besosh në Jezuin do të të japë një jetë pa dhimbje, nuk i ka kuptuar të vërtetat e Biblës. Mendo për dhimbjen që përjetoi vjedhësi pasi i besoi Jezuit: dhimbja e kryqëzimit iu bë më e fortë me çdo orë që kalonte; plagët në duar e këmbë u zgjeruan, duke shkaktuar torturë të padurueshme; temperatura e trupit iu rrit. Pra, vjedhësi përjetoi dhimbje më të mëdha fizike pasi i besoi Jezuit se përpara.

Do të të duhet t'i besosh Jezuit në errësirë, dhe do të ketë edhe momente kur do të duhet t'i besosh Atij në dhimbje.

TË BESOSH PAVARËSISHT VDEKJES

Ashtu si vjedhësi, do të të duhet t'i besosh Jezuit kur të të vijë ora e vdekjes.

Disa vite më parë, një pastor i moshuar ishte i sëmurë rëndë dhe nuk i kishte mbetur shumë kohë për të jetuar. Një pastor tjetër shkoi ta vizitonte dhe i tha drejtpërdrejt: Kam ardhur të të tregoj sesi të vdesësh. Harroje jetën tënde të krishterë".

"Ta harroj? Vërtet?" – u habit pastori i sëmurë.

"Po, vërtet. Dhe ja pse: nëse rri shtrirë duke menduar për atë që ke bërë për Jezuin, shumë shpejt do të fillosh të shohësh edhe ato që nuk ke bërë për Të, ato që mund të kishe bërë më mirë për Të. Nëse e bën këtë, do ta gjesh veten të rrethuar nga dyshimi dhe frika."

"Atëherë, çfarë duhet të bëj?" – pyeti ai.

"Harroje ç'ke bërë apo ç'nuk ke bërë për Jezuin dhe mos ia ndaj sytë asaj që Jezui ka bërë për ty".

Mënyra për të vdekur është mënyra për të jetuar. Harro ç'ke bërë apo ç'nuk ke bërë për Jezuin dhe ki besim të plotë në atë që Jezui ka bërë për ty në kryq.

Sot vjedhësi është në parajsën qiellore. Jo se ishte pa mëkat ose se jetoi një jetë mjaftueshmërisht të mirë. Ai është në parajsë, se Jezui pagoi çmimin për mëkatin e tij dhe i dha atij një jetë të re e të përjetshme. Çka bëri për vjedhësin, Jezui është në gjendje ta bëjë edhe për ty.

DALLIMI

Por, mos harro se ishin dy vjedhës. Njëri u shpëtua, tjetri jo. Të dy kishin të njëjtën nevojë dhe të njëjtën mundësi. Të dy ishin afër Jezuit. Të dy dëgjuan atë të lutej: "Atë, fali, se nuk dinë çfarë po bëjnë". Por, ja, ku është dallimi: Ndërsa njëri u kthye te Jezui me pendim e besim, tjetri ndenji larg.

Ti mund të thuash: *"Nuk dua të vendos tani për këto gjëra. Dua t'i lë kohë vetes".*

Nëse vepron kështu, do të ndodhin njëra nga të dyja, ose kur të pendohesh do të dëshiroje ta kishe bërë më herët, ose zemra jote do të ngurtësohet ndaj Jezuit dhe nuk do të shkosh kurrë tek Ai. Prandaj, tani, shko te Jezui me besim e pendim.

Ose ndoshta ke frikë se është tepër vonë për ty të kthehesh tek Ai. Mos e harro vjedhësin në kryq. Nuk qe tepër vonë për të, as është tepër vonë për ty.

Tani është koha për t'u kthyer kah Jezui, për të kërkuar prej Tij, dhe për të besuar në Të. Sa më herët, aq më mirë, por më mirë vonë se kurrë. Ja një lutje që mund të bësh:

*Zot, unë rrëfej se jam mëkatar dhe se nuk e meritoj të hyj në
parajsën Tënde.*

Por besoj se Ti je mbreti dhe se vdiqe në kryq për mua.

*Prandaj, të lutem të kujtohesh për mua e të më marrësh në
mbretërinë Tënde.*

*I besoj premtimit Tënd se ata që vijnë te Ti nuk do të hidhen kurrë
jashtë.*

 **Hape Biblën**